

**NE GJYKATËN KOMUNALE TË PRIZRENIT**  
**P. nr. 385/10**  
**25 Mars 2010**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjyqtari Malcolm Simmons si kryetar i trupit gjykues, me procesmbajtës Robert Abercrombie, Eriona Bitri - Brading dhe Sophie Ashmore, ne veprën penale kunder Agim Zeka, i akuzuar konform aktakuzës PP. nr. 1916/09 te parashtruar nga Prokuroria komunale ne Prizren me datën 8 Gusht 2009 me veprën penale te dhënies se ryshfetit nen nenin 344 (1) te Kodit te Përkohshëm Penal te Kosoves; mbas mbajtjes se gjykimit publik me 23 dhe 25 Mars 2010 ku Prokurori Komunal është përfaqësuar nga Gabriele Walentich, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, avokati Rame Gashi, me 25 Mars 2010 morri dhe publikisht shpall si ne vijim:

**AKTGJYKIMIN**

I pandehuri Agim Zeka lindur me 29 Janar 1971 ne fshatin Makresh, komuna e Gjilanit, i biri i Jahi dhe Fatime ( vajzërisë Ademi), adresa e tanishme e banimit nr 2, rruga 1 "Qagllavica", Komuna e Prishtinës, Shqiptar Kosovar, me numër te identifikimit 1004148599, i martuar, babai i dy fëmijëve, shkollimin e përfunduar, te një gjendjes se mire ekonomike, nuk ka dënime te me hershme, i cili ishte ne arrest shtëpiak gjate periudhës kohore nga 30 Qershor 2008 deri me 11 Gusht 2008, është:

**FAJTOR**

Sepse gjate vitit 2005/2007 i pandehuri gjersa vepronte si ndërmjetësues, akordon për gjyqtarin e gjykatës se qarkut te Prishtinës te holla ne se paku shumen prej 53.000 Eurove dhe veturën motorike Volkswagen Caddy me qellim qe gjyqtari do te zhvilloj ne kuadër te fushëveprimit te autoritetit te tij

zyrtar, një akt zyrtar apo ndonjë akte tjetër te cilën nuk është dashur te kryej, apo te dështoj te kryej një akt zyrtar apo ndonjë akt tjetër te cilën ai do te kishte kryer.

Nga kjo arsye i pandehuri ka kryet veprën penale te dhënies se ryshfetit si ndërmjetësues nen nenin 344 (1) te Kodit te Përkohshëm Penal te Kosoves.

### **DËNOHET**

Me burgim ne afate kohor prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh. Ne vazhdim, konform nenit 54 (2) te Kodit Penal te Kosoves e shqipton gjobën ne shume prej 2000 (dy mije) Eurove.

Konform nenit 73 te Kodit Penal te Kosoves, dënimi i burgimit duhet te përfshij kohen e vuajtur ne arrest shtëpiak nga data 30 Qershor 2008 deri me 11 Gusht 2008.

Ne pajtim me nenin 102 (1) i pandehuri duhet te paguaj shpenzimet e kësaj procedure gjyqësore. I pandehuri duhet te paguaj shumen prej 50 (pesëdhjete) Eurove ne emër te paushallit gjyqësor.

Konform nenit 391 (1) (6) aktgjykimi i plotfuqishëm mund te shpallet ne media publike.

### **ARSYETIM**

Zyra Komunale e prokurorise se Prizrenit ka parashtruar aktakuzën PP. Nr. 1916/09 te datës 8 Gusht 2009 kunder Gjyqtarit te Gjykatës se Qarkut te Prishtinës ( ne vazhdim "gjyqtar") dhe Agim Zekës ( ne vazhdim "i pandehuri") te cilët ishin te akuzuar me vepër penale te marrjes se ryshfetit nen nenin 343 te Kodit te Përkohshëm Penal te Kosoves dhe dhënies se ryshfetit konform nenit 344 te Kodit te Përkohshëm Penal te Kosoves.

Ne fillim te shqyrtimit kryesor i pandehuri u deklarua i fajshëm për veprën penale te dhënies se ryshfetit nen nenin 344 (1) te Kodit te Përkohshëm Penal te Kosoves.

Pas kësaj, konform nenit 34 te Kodit te Procedurës Penale te Kosoves, gjykata e lëshon aktvendimin ku urdhëron ndarjen e procedurës kunder te pandehurve te lartcekur.

Ne aktakuze është pohuar se gjate viteve 2005/2007 Vesel Alshiqi, ne disa raste, me ndërmjetësimin e Agim Zekës, kanë akorduar biseda për Gjyqtarin e Gjykatës se Qarkut te Prishtinës, personi zyrtar, te holla ne shume te përgjithshme prej 123.000 Euro, dhe po ashtu akorduan mbi gjyqtarin e lartcekur veturën motorike Volkswagen Caddy, ashtu qe gjyqtari brenda fushëveprimit te tij zyrtar, zhvilloi një akt zyrtar te cilën nuk është dashur te e kryej - ne veçanti shfajësimin apo se paku lirimin e Afrim Alshiqit dhe Besim Alshiqit, ku secili prej tyre ishin te akuzuar me vrasje. Është pretenduar ne aktakuze, se nga kjo arsye, rrjedh se i pandehuri ka kryer veprën penale te dhënies se ryshfetit, konform nenit 344 (1) te Kodit te Përkohshëm Penal te Kosoves.

Nuk është kontestuese se gjyqtari ishte kryetari i trupit gjykues ne rastin e Afrim dhe Besim Alshiqit.

Gjykata gjene se gjyqtari ishte "personi zyrtar" ne kuptim te nenit 344 te Kodit te Përkohshëm Penal te Kosoves.

I pandehuri ka pranuar qe ai është pajtuar me kushëririn Vesel Alshiqi qe te veproj si ndërmjetësues ne ujdinë e tij te fundit me gjyqtarin.

Gjersa ishte duke kryer rolin e ndërmjetësuesit, i pandehuri pranoi qe ka marrur nga Vesel Alshiqi para te gatshme ne shume prej 53.000 Eurove, shumen te cilën ia dha gjyqtarit. I pandehuri ishte i pranishëm se paku ne njërin prej rasteve kur Vesel Alshiqi e takoi gjyqtarin. Ne vazhdim i pandehuri pranoi qe ai i kishte dhëne gjyqtarit veturën motorike Volkswagen

Caddy te cilën Vesel Alshiqi e ka sjellur nga Austria për gjyqtarin.

Gjykata gjene se te holla te cilat i pandehuri i kishte dhëne gjyqtarit gjersa ka vepruar si ndërmjetësues për Vesel Alshiqin ishte e menduar si ryshfet me qellim te ketë ndikim ne rezultatin e gjykimit te Afrim Alshiqit dhe Besim Alshiqit dhe te siguroj shfajësimin apo/ose lirimin te të pandehurit ne fjale ne këtë rast.

I pandehuri ka mohuar qe ai kishte përfituar financiarisht nga aranzhimet e tij me Vesel Alshiqin. Asnjë prove nuk është prezantuar ne gjykate qe te dëshmoje te kundërtën.

Gjykata gjene se i pandehuri, gjersa ishte duke vepruar si ndërmjetësues akordon për gjyqtarin te holla ne se paku shumen prej 53.000 Eurove dhe veturën motorike Volkswagen Caddy me qellim qe gjyqtari do te zhvilloj ne kuadër te fushëveprimit te autoritetit te tij zyrtar, një akt zyrtar apo ndonjë akte tjetër te cilën nuk është dashur te kryej, apo te dështoj te kryej një akt zyrtar apo ndonjë akt tjetër te cilën ai do te kishte kryer

I pandehuri duke e deklaruar veten fajtor për veprën nen nenin 344 (1) te Kodit te Përkohshëm Penal te Kosoves, konform nenit 359 (5) te Kodit te Procedurës Penale te Kosoves, duke qene i kënaqur se kërkesat nen nenin 315 (1) te Kodit te Procedurës Penale janë plotësuar, gjykata konkludoi procedurën e dëshmimeve dhe vazhdoi shqyrtimin kryesor me fjalimet përfundimtare.

Gjykata është e pëlqimit se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat nen nenin 316 paragrafët 1-3 te Kodit te Procedurës Penale.

Gjykata e morri parasysh rrethanat personale te të pandehurit, faktin qe nuk kishte dënime te me hershme dhe kjo i jep kredi te plote për deklarimin e tij te hershem te fajësisë. Gjykata është e pëlqimit se dënimi është ne proporcion me te gjitha rrethanat

Për arsyet te cekura këtu, nëpërmjet kësaj unë e shpalli këtë aktgjykim

Me 25 Mars 2010

Gjyqtari Malcolm Simmons  
Kryetari i trupit gjykues

Procesmbajtësi

**KËSHILLA JURIDIKE:** konform nenit 398(1) te Kodit te Procedurës Penale te Kosoves, personat te autorizuar mund te parashtrojnë ankesën kunder këtij aktgjykimi ne afat kohor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e shërbimit te kopjes se aktgjykimit.



KËSHILLË E KOPJES E VËRTETON  
KËSHILLË E KOPJES E VËRTETON

Punëtori i autorizuar  
Gjyqësor i autorizuar